

Zgjidhje të bazuara në natyrë për një qëndrueshmëri të drejtë në qytetet e rajonit Adriatik-Jon – NATURED

Interreg  Co-funded by the European Union

IPA ADRION

NATURED



Rajoni Adriatiko-Jonian përfaqëson një nga zonat më unike të biodiversitetit në Evropë, me ekosisteme të ndryshme. Ai ndan dobësi të përbashkëta dhe në vitet e fundit është shndërruar në një pikë të rëndësishme të ndikimit të ndryshimeve klimatike. Pasojat, si përmblytjet, thatësit, rrëshqitjet e dheut, stuhitë dhe zjarret në pyje, janë të dukshme dhe janë bërë gjithnjë e më të shpeshta, duke ndikuar në komunitetet e cënueshme dhe duke kërkuar përpjekje kolektive dhe veprime të përbashkëta. Meqenëse efektet e ndryshimeve klimatike tejkalojnë kufijtë gjeopolitikë, një qasje transnacionale është thelbësore. Projekti **NATURED** synon të promovojë një qasje të drejtë, të sigurt dhe gjithëpërfshirëse ndaj qëndrueshmërisë, të përqendruar në zona konkrete, e bazuar në aktivitete të ndryshme të ndërlydhura. Këto përfshijnë kuptimin e ndërveprimeve midis klimës dhe qyteteve, krijimin e bazave të të dhënave dhe hartave digjitale për ndjeshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike dhe rreziqeve në zona të ndryshme urbane, si dhe angazhimin e qytetarëve dhe palëve të interesuara në përcaktimin e planeve të veprimit për zgjidhje të bazuara në natyrë. Këto zgjidhje do të testohen përmes aktiviteteve pilot dhe më pas do të integrohen në planet e punëve publike të qyteteve, me qëllimin përfundimtar që zgjidhjet më efektive të ripërsëriten dhe të zbatohen në një shkallë më të gjerë.

Projekti NATURED ofron zgjidhje të bazuara në parimet e natyrës për rajonin ADRION, i cili po përballet me një krizë të lidhur me ndryshimet klimatike


Duke zbatuar zgjidhje përshtatëse të bazuara në parimet e natyrës, përfituesit kryesorë të të cilave do të jenë grupet më të cënueshme, projekti **NATURED** do të inkurajojë politikëbërësit dhe palët e interesuara që të parandalojnë efektet e ndryshimeve klimatike në zona të ndryshme urbane, veçanërisht përmblytjet e rrëmbyeshme dhe fenomenin e ishujve të nxehtësisë urbane.

Materialet dhe metodat

Duke zbatuar një qasje transnacionale të përqendruar në zona konkrete, projekti **NATURED** synon të forcojë qëndrueshmërinë e zonave urbane ndaj ndryshimeve klimatike. Materialet përfshijnë grupe të dhënash klimatike me kod të hapur (p.sh. Copernicus dhe shërbimet kombëtare meteorologjike), harta GIS dhe matrica të cënueshmërisë/rrezikut, të cilat u zhvilluan për vlerësimin e rreziqeve si ishujt e nxehtësisë dhe përmblytjet urbane, duke krijuar një bazë provash për planet lokale të veprimit. Metodatat kombinuan vlerësime teknike me procese pjesëmarrëse. Analiza e të dhënave u mbështet nga anketa dhe konsultime me palët e interesuara për të përfshirë prioritetet lokale dhe për të verifikuar skenarët e rrezikut klimatik. Grupe të ndryshme të komunitetit u përfshinë në zhvillimin e zgjidhjeve të përshtatura në nivel lokal, të bazuara në parimet e natyrës, ndërsa aktivitete pilot u realizuan për të testuar këto zgjidhje në kushte reale. Seminare transnacionale, rishikime të ndërsjella dhe plane të përbashkëta veprimi lehtësuan shkëmbimin e njohurive në nivel ndërkombëtar dhe siguruan që rezultatet të mund të riprodhohen dhe të jenë në përputhje me objektivat e Bashkimit Evropian për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Kjo metodologji e integruar siguroi njëkohësisht rigorozitet shkencor dhe një përfshirje të fortë të komunitetit në hartimin e strategjive për një qëndrueshmëri të qëndrueshme të zonave urbane.

Rezultatet kryesore:

- Një strategji e përbashkët dhe plan veprimi për të reduktuar cënueshmëritë/rreziqet me të cilat përballen qytetet dhe për të përmirësuar qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike përmes zgjidhjeve të bazuara në parimet e natyrës.
- Aktivitete pilot për testimin e zgjidhjeve të bazuara në natyrë, të cilat rrjedhin nga një qasje e bazuar në territor, me qëllim rritjen e qëndrueshmërisë së qyteteve ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike në zonat urbane.
- Organizata që bashkëpunojnë në nivel ndërkombëtar, duke përdorur ndikimin e tyre në politika, duke shkëmbyer ekspertizë dhe praktikat më të mira për të gjetur zgjidhje të përbashkëta të bazuara në natyrë për përballimin e pasojave të ndryshimeve klimatike, pra për të përmirësuar qëndrueshmërinë e qyteteve dhe rajoneve.



Diskutim:

Si mund të integrohen zgjidhjet e bazuara në parimet e natyrës në zonat urbane për të zbutur ndikimet e ndryshimeve klimatike, duke përfshirë ishujt e nxehtësisë, përmblytjet dhe kushtet ekstreme të motit?

Çfarë roli mund të kenë mjetet digjitale, hartat e rrezikut dhe matricat e cënueshmërisë në drejtimin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në zonat urbane?

Cilat janë mënyrat më të mira për të siguruar pjesëmarrjen e qytetarëve dhe palëve të interesuara në projektimin dhe zbatimin e zgjidhjeve të bazuara në parimet e natyrës?

Si duhet që komunat të integrojnë zgjidhjet e bazuara në natyrë në programet e punëve publike dhe në strategjitë afatgjata për klimën?

Si mund të ndihmojë bashkëpunimi transnacional qytetet në ndarjen e zgjidhjeve dhe harmonizimin e politikave në të gjithë rajonin Adriatiko-Jon?



<https://natured.interreg-ipa-adriion.eu/>

Projekti **NATURED** është bashkëfinancuar nga fondet e **Bashkimit Evropian** përmes programit **Interreg IPA ADRION**.